



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË /OPSTINSKI SUD ZA  
PREKRSAJE U PRISTINI/MUNICIPAL OFFENCES COURT IN PRISTINA**

Nr.regj. 14829/2012

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Ilmi Zherka nga Gjakova. për kundërvajtje nga nen 6 par.1 nën par.1.2 lidhur me nenin 17 par.1 nën par.1.1 të Ligjit për Deklarimin,Prejardhjen dhe Kontrollën e Pasurisë të zyrtarëve të lartë publik,dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollën e dhuratave për të gjithë personat zyrtar e ne bazë të nenit 73,74,195,199 dhe konformë nenit 10 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, mejt këtë:

AKT VENDIM

**I PANDEHURI:** Ilmi Sadik Zherka i lindur më 1955 në Gjakovë ku dhe tani jeton rr. Kushtrim Hoxha nr.6 i martuar baba i 1 fëmijët i papunë

E s h t ē p ē r g j e g j ē s

Sepse si Zyrtar i Lartë Publik në Universitetin e Prishtinës-Prodekan për Financa në FNA,,nuk e ka bërë deklarimin e pasurisë pranë Agjencisë Kundër Korruptionit për vitin 20112,në afatin e caktuar ligjor edhe pse ka qenë i përfshirë në listen e Zyrtarëve të Lartë Publik të cilët janë të obliguar të deklarojnë pasurinë. Me veprim të këtillë ka kryer kundërvajtje të nga nenit 6 par.1 nën par.1.2 lidhur me nenin 17 par.1 nën par.1.1 të Ligjit për Deklarimin,Prejardhjen dhe Kontrollën e Pasurisë të zyrtarëve të lartë publik,dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollën e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, andaj për këtë I jet.

QORTIM

Shpenzime të procedures nuk ka patur.

Nga nië kopie të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

## A r s y e t i m

**Agjencia Kundër Korruptionit në Prishtinë** parashtrjet gjykates kërkesën nr.01/1612/2012, më dt.02.05.2012, për fillimin e procedures kundërvajtje kundër të pandehurit Ilmi Zherka dhe për kundërvajtjen e përshtkuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në seancën gjyqësore të caktuar për date 15.10.2012, i pandehuri me rastin e marrjes në pyetje e pranon se për vitin 2012, nuk e ka deklaruar pasurinë pranë Agjencisë Kundër Korrupsionit duke menduar se nuk gjendet në listen e zyrtarëve të Universitetit të Prishtinës që kanë qenë të obliguar për deklarim të pasurisë. Thekson gjithashtu se ka patur një pagë minimale që nuk ka kaluar shumën 559 EU,në personel arsimor dhe ka menduar se nuk është i obliguar të deklarojë pasurinë duke qenë ushtrues detyre i Prodekanit pranë FNA dhe atë me kohë të caktuar gjërë 30.09.2012.Më date 31.05.2012 ka dhënë dorëheqje nga pozita e Prodekanit dhe tanj gjendet i papunë.

Nga tē dhënat e parashtruarat nē kërkesë, si dhe deklarata e tē pandehurit, Gjykata konstatoi se i njëjtë e ka kryer kundërvajtjen ashtu sid që rëndon kërkesa për cka u shpall i faishëm.

Me rastin e caktimit të dënimit Gjykata mori pëpr bazë të gjitha rrethanat e parapara me nenin 7 të LMK-së dhe pasi konstatoi se ekzistojnë rrethana lehtësuese të cilat në masë të konsideruar e zvogëlojnë përgjegjësinë, në vend të dënimit të përcaktuar iu dha vetëm **QORTIM**.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitivë të këtij aktyvendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE**: Kundër këtij aktvendimi ankesë mund ti ushtrohet Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh, prej ditës se marries së ketij aktvendimi nepërmes të kësaj Gjykate dhe pa taksa.

VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

Me dt 19 10 2012

KRYETARLI GJYKATËS

Mustaf  Selim



 <b>PRISHTINE</b> GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF KOSOVO <b>AGENCIJA KOMBËTARE KORRUPSIONIT</b> <b>AGENCIJA PROTIV KORRUZIONE</b> <b>ANTI-CORRUPTION AGENCY</b>	
<p>Dok. No.: <u>DPK / DMP</u></p> <p>Date: <u>01</u></p> <p>No. of page: <u>1</u> of <u>strаница</u></p> <p>No. of pages: <u>1</u></p>	<p>Br. Prot. Br. prot. Prot. No.</p> <p><u>03-4146/12</u></p> <p>Date: Datum Date</p> <p><u>14.11.2012</u></p>